

# STATUTI DHE AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

## SHOQERIA "2R ENERGY" sh.p.k

Në këtë statut

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare";
- "Statuti" është Statuti i shoqërisë;

### KREU I THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

#### Neni 1:

#### Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

- (1) Sot, më date 13.09.2018 ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "2R ENERGY" sh.p.k
- (2) Themeluesi i shoqërisë është:  
**- Person Fizik Ilir Blloshmi me NIPT L13203801D, me Adrese Ura e Draxhit Kavaj , shtetas shqiptar, lindur me 03.09.1973, lindur ne Sopot, Librazhd dhe banues ne Kavaj , me nr.personal H30903061K madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar.**
- (3) Selia e shoqërisë do të jete ne : **Kavaj, lagjia 4 Rruga e Tironsave, porta numer 32**

#### Neni 2:

#### Objekti

#### Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Prodhimi energjise elektrike nga burimet e rinovueshme. Ndërtimi i hidrocentraleve, termocentraleve apo impianteve te cilat bejne te mundur shfrytezimin e energjise qe gjenden ne natyre dhe qe jane te rinovueshme. Shitja e energjise elektrike klienteve dhe blerja e energjise elektrike nga operatore te ndryshem privat apo shteteror brenda dhe jashte vendit. Transmetimi i energjise elektrike ne sistemin e tensionit te larte, funksion i cili perfshin transmetimin ose interkonjeksionin nderkombetar. Perdorimin e sistemeve te linjave, strukturave mbeshtetese dhe pajisjesh, transformuese e kontrolluese per transmetimin e energjise elektrike.

Operator i sistemit te transmetimit te energjise elektrike dhe te dispecerimit 2 (axhustim ose rregullimi i prodhimit te energjise elektrike ne nivel kombetar. Shperndarjen, transportin e energjise elektrike ne sistemet shperndarese te tensionit, te mesem dhe te ulet, duke patur parasysh shperndarjen deri tek konsumatori i fundit. Shoqeria mund te bashkepusoje dhe/ose te marre direkt ose indirekt interesa, ne shoqeri, firma, agjenci dhe ndermarrje te tjera, te cilat mund te kene edhe qellime te tjera aktiviteti. Import makinerish industriale qe do te bejne te mundur kryerjen dhe realizimin e objektit te kompanise. Shoqeria ka per objekt kryerjen e cdo veprimtarie te lejuar nga ligji dhe /ose pjesemarrjen ne cdo veprimtari apo aktivitet te ligjshem qe mund te kryej nje shoqeri ne baze te legjislacionit shqiptar.

#### Neni 3:

#### Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat (vetëm nëse është e përcaktuar):

#### **Neni 4:**

##### **Selia**

(4) Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: **Kavaj, lagjia 4 Rruga e Tironsave, porta numer 32.**

(5) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon :  
**2renergy@gmail.com**

## **KREU II KAPITALI**

#### **Neni 5**

##### **Kapitali themeltar**

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është: 100 Lekë .

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortakui **vetem Person Fizik Ilir Blloshmi me NIPT L13203801D me Adrese Ura e Draxhit Kavaj**. Zoterues i kuotave me vlerë të përgjithshme 100 leke që përben 100%e kapitalit themeltar të shoqërisë.

#### **Neni 6:**

##### **Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

#### **Neni 7**

##### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin eshoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar meligj.



Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### **KREU III**

#### **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

##### **Neni 8**

##### **Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per cheshtjet emeposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare teshoqerise;
- b) ndryshimet estatutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" të kësajpike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqerisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) cheshtje të tjera të parashikuara nga ligji apostatuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e pergjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqerisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e pergjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së pergjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

##### **Neni 9**

##### **Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme**

Asambleja e pergjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e pergjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

##### **Neni 10**



## Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind tëkuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## Neni 11 Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

## Neni 12 Përjashtimi nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

## Neni 13





## Administrimi

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

- Të dhënat e identifikimit: **Ilir Blloshmi ,shtetas shqiptar, lindur me 03.09.1973, lindur ne Sopot, Librazhd dhe banues ne Kavaj , me nr.personal H30903061K madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar.**

### Neni 14

#### Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja epërgjithshme;

b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;

c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën eshoqërisë;

dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret janë të detyruar të thërrasin Asamblye të Përgjithshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuar brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare



të certifikuar. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Padi të, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.


## **Neni 15** **Përgjegjësia e Administratorit**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasoja të marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë nëmjes;
  - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këtodispozita;
  - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merretvendim;
  - ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
  - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrësolidare.
4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare , kryen veprimet emëposhtme:
- a) u kthen ortakëvekontributet;
  - b) u paguan ortakëve interesa apodividendë;
  - c) u shpërndan aktivetshoqërisë;
  - ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
  - d) jepkredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.



**KREU IV**  
**VITI FINANCIAR-EKSPERTET**

**Neni 16**

**Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

**Neni 17**

**Ekspertet**

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqërise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana eortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

**KREU V**  
**PRISHJA –RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

**Neni 18**

**Prishja dhe likuidimi**

Shperndarja ose prishja e shoqërise mund te behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin esaj;
- b) me vendim të Asamblese seOrtakeve;
- c) me hapjen e procedurave tëfalimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim tëgjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqërise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper“.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 19**

**Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja**





Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

**Neni 20**  
**Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislativës shqiptare. Nëse nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 21**

**Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

**O R T A K U I S H O Q E R I S E**

**“2R ENERGY” shpk**

**ILIR BLOSHMI**

